

TOP NEWS shpk

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Mbeshtetur ne Ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pas qyrat Financiare", te ndryshuar, dhe ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara)

PERMBAJTJA

PASQYRAT FINANCIARE:	FAQE
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E E PERFORMANCES	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	3
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	4
SHENIME TE PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 16

Top News

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2023
në LEK

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	46,017	1,391,736
Investime		-	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	15,358,617	6,340,136
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		-	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	732,650	100,000
Inventarë		-	-
Shpenzime të shtyra		-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		16,137,284	7,831,872
Aktivët afatgjatë			
Aktive financiare		-	-
Aktive afatgjatë materiale	7	2,793,524	-
Aktive afatgjatë jomateriale		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjatë		2,793,524	-
Totali i aktiveve		18,930,808	7,831,872
DETYRIMET			
Detprime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregtare	8	13,386,875	2,592,575
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		-	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Detprime tatimore	9	3,103,035	1,590,081
Të ardhurat e shtyra	10	5,000,000	-
Provizione		-	-
Të tjera detprime	11	1,062,927	-
Totali i detprimeve afatshkurtra		22,552,837	4,182,656
Detprime afatgjatë			
Detprime të tjera afatgjatë	12	13,450,000	13,450,000
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura		-	-
Të ardhurat e shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detprime tatimore të shtyra		-	-
Totali i detprimeve afatgjatë		13,450,000	13,450,000
Totali i detprimeve		36,002,837	17,632,656
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	13	100,000	100,000
Primi i lidhur me kapitalin		-	-
Rezerva rivlerësimi		-	-
Rezerva të tjera		-	-
Fitime të mbartura		(9,900,784)	-
Fitimi i ushtrimit	19	(7,271,245)	(9,900,784)
Totali i kapitalit		(17,072,029)	(9,800,784)
Totali i kapitalit dhe detprimeve		18,930,808	7,831,872

TOP NEWS shpk
(Vlerat janë në Lek)

Top News

Pasqyra e Performances për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 në LEK

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	65,755,603	23,822,878
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	6,649,771	9,542,928
Totali i të ardhurave		72,405,374	33,365,806
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera :	16	(15,998,754)	(4,672,344)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		-	-
2) Të tjera shpenzime		(15,998,754)	(4,672,344)
Shpenzime të personelit	17	(63,290,220)	(38,286,659)
1) Paga dhe shpërblime		(55,869,611)	(33,257,366)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(7,420,609)	(5,029,293)
Zhvierësim i aktiveve afatgjata materiale		(157,024)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18	(157,024)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		-	-
Të ardhura të tjera		-	-
1) Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
2) Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata		-	-
3) Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme		-	-
Zhvierësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktiv		-	-
Shpenzime financiare	19	(230,620)	(307,587)
1) Shpenzime të ardhura nga kembimi		(291,696)	(307,587)
2) Shpenzime të tjera financiare		61,076	-
Fitimi/humbja para tatimit		(7,271,245)	(9,900,784)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	20	-	-
Fitimi/humbja e vitit		(7,271,245)	(9,900,784)

TOP NEWS shpk*(Vlerat janë në Lek)*

Top News

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	100,000	-	-	(9,900,783)	(9,800,783)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2023					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				(7,271,245)	(7,271,245)
Transferime ne fitim/humbje te mbartura			(9,900,784)	9,900,784	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					
Ematimi i kapitalit të nënshkruar					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	100,000	-	(9,900,784)	2,629,539	(17,072,028)

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë miratuar më ___ mars 2023.

Administratorja

Lorela HOXHA

LORELA HOXHA

TOP NEWS

Nuis: M116130010 • Tirana - Albania

Perpiluesja e Pasqyrave

Jerina LALA

J.L.

TOP NEWS shpk
(Vlerat janë në Lek)
Top News
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(7,271,245)	(9,900,783)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	-	-
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	157,024	
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(9,651,130)	(6,440,136)
Rënie/(rritje) në inventarë		
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	5,000,000	
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra		
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	11,857,227	2,592,575
Rritje/(rënie) në detyrime tatimore	1,512,954	1,590,081
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	1,604,830	(12,158,263)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,950,548)	
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,950,548)	
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	100,000
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara	-	13,450,000
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	-	
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	13,550,000
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(1,345,718)	1,391,737
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,391,736	
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	46,018	1,391,737

4

1- TE PERGJITHSHME

Shoqëria "TOP NEWS "sh.p.k është e krijuar ne dt.01.03.2021 te Rrethit Tirane

Aktiviteti kryesor i saj është :veprimtari ne fushen e mediave audiovizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim programeve televizive,informacioneve, agjensi publicitare, sherbime monitorimi, sherbime publicitare, shperndarje reklame ne media te shkruara apo elektronike, prodhime dhe produksione reklamash dhe shitie te tyre per llogari te te treteve(porositesve), sherbime IT dhe konsulence It .Shperndarje dhe tregetim te materialeve publicitare. Veprimtari ne fushen e medias se shkruar dhe audio vizuale. Marketing dhe shperndarje e prodhimeve te saj etj

Kapitali themeltar është: 100.000 leke me ortak te vetem znj . Lorela HOXHA . Perfaqesues ligjor është Znj. Lorela HOXHA .

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi. Kontrata kryesore me klientin kryesor ka përfunduar gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2023. Deri në momentin e përgatitjes së këtyre pasqyrave shoqëria nuk hyrë në asnjë kontratë me klient të rinjë.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

2.5 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, informacioni krahasues rregullohet në përputhje me ndryshimet në prezantim në periudhën aktuale të raportimit. Ndryshimet bëhen për të paraqitur më me drejtësi natyrën e biznesit. Ato zbatohen respektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 shtë detajuar si më poshtë:

Kurse e kembimit	31.12.2023	31.12.2022
Euro/Leke	103.88	114.23
USD/ Leke	93.94	107.05

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me

(Vlerat janë në Lek)

kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën

(Vlerat janë në Lek)

kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të kaluar, Kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual që mund të matet me besueshmëri, dhe ka të ngjarë që një rrjedhë e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksin e ardhshëm të parave të gatshëm me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Provizionet shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka indikacione për ndonjë rrjedhje të parave për shlyerjen e ndonjë detyrimi, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

(a) Tatim fitimi

Tatim fitimi, i njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, eshte detyrimi tatimor i pritshem per te ardhurat tatimore te vitit duke perdorur normen e tatimit te miratuar ne ditën e pergatitjes se bilancit kontabel.

Ne vitin ushtrimor 2023 Shoqeria Top News shpk ka rezultuar me rezultat negativ (humbje) prej 7.271.245 Leke.

4- MJETE MONETARE

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumen e ekstrakteve te bankes me 31.12.2023. Shoqeria ka llogari bankare ne leke. Gjendja e likuiditeteve sipas bankave me 31.12.2023 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Mjete monetare në bankë	<u>46,017</u>	<u>1,391,735</u>
Në lekë	4,051	1,117,413
Në monedhë të huaj	41,966	274,322
Mjete monetare në arkë	<u>46,017</u>	<u>1,391,735</u>

5. KERKESA TE ARKETUESHME

Shuma ne pasqyra perfaqeson detyrimin e te treteve ndaj shoqerise per fatura te palikujduara ne vlere

15,358,617 ALL

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Klientë në lekë	7,880,093	1,557,787
Klientë në monedhë	<u>7,478,524</u>	<u>4,782,349</u>
	<u>15,358,617</u>	<u>6,340,136</u>

6- KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME AFATSHKURTRA

Gjate Vitit 2023 Top News ka kerkesa te tjera te arketueshme afatshkurter .

TOP NEWS shpk
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
TVSH e arkëtueshme		-
Të tjera llogari të arkëtueshme	732,650	100,000
	<u>732,650</u>	<u>100,000</u>

7. AKTIVET AFATGJATE MATERIALE

Gjate vitit 2023 Top News ka blere asete duke investuar ne teknologji , kemi shtesa ne instalime makineri paisje dhe ne paisje informatike .

	Ndërtesa	Instalime te pergjithshme	Pajisje infor	Mobilje e	Mjete tran	Te tjera	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2023							
Shtesa		2,687,215	263,333	-	-	-	2,950,548
Pakësime		-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023		2,687,215	263,333	-	-	-	2,950,548
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2013							-
Amortizimi i vitit		135,019	22,005				157,024
Pakësime		-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023		135,019	22,005	-	-	-	157,024
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2022						-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023		2,552,196	241,328	-	-	-	2,793,524

8. LLOGARIA TE PAGUESHME TREGTARE

Perfshin detyrimet qe ka Top News ndaj furnitoreve me 31.12.2023 si me poshte . Kjo e ndare ne Furnitore ne lek dhe ne Furnitore ne Euro

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Llogari të pagueshme tregtare lek	6,000,000	341,137
Llogari të pagueshme tregtare euro	7,386,875	2,251,438
	<u>13,386,875</u>	<u>2,592,575</u>

9.DETYRIMET TATIMORE

Ne kete ze jane perfshire Detyrimet tatimore qe ka Top News per tatimin mbi te ardhurat , Tvsh per te paguar dhe sigurimet shoqerore per muajin Dhjetor 2023.

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat persona	871,002	408,368
Tatim në burim		-
TVSH për t'u paguar	1,071,055	253,295
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,160,978	928,419
	<u><u>3,103,035</u></u>	<u><u>1,590,082</u></u>

10.TE ARDHURAT E SHTYRA

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Te Ardhura te shtyra	5,000,000	-
	<u><u>5,000,000</u></u>	<u><u>-</u></u>

11. DETYRIMET TE TJERA

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Paga per tu paguar	17,900	-
Te tjera	1,045,028	-
	<u><u>1,062,927</u></u>	<u><u>-</u></u>

12 - HUA AFATGJATE

Gjate Vitit 2022 Top News ka hua afatgjate si me poshte e cila paraqitet dhe ne 2023

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Hua te tjera	13,450,000	13,450,000
	<u><u>13,450,000</u></u>	<u><u>13,450,000</u></u>

13.KAPITALI I SHOQERISE

- Kapitali I shoqerise eshte 100.000 leke
- Fitime humbje te ushtrimit eshte ne vleren (7,271,245) leke e cila perfaqeson rezultatin Humbje te shoqerise per periudhen 01 Janar 2023- 31 Dhjetor 2023.

14. TE ARDHURAT

Te ardhurat janë realizuar nga aktiviteti kryesor I shoqërisë . Per vitin 2023 zeri te “ Te ardhura nga aktiviteti I shfrytezimit është paraqitur sipas SKK per permiresuar .

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Te ardhura nga aktiviteti I shfrytezimit	65,755,603	32,819,525
	<u>65,755,603</u>	<u>32,819,525</u>

15. TE ARDHURA TE TJERA

Ne kete ze kemi paraqitur te ardhura te tjera te shfrytezimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Te Ardhura nga te drejta Transmetimi	6,649,771	546,281
	<u>6,649,771</u>	<u>546,281</u>

16. TE TJERA SHPENZIME

Ne kete ze jane paraqitur shpenzimet e kryera per periudhen janar dhjetor 2023 nga shoqëria si me poshte ;

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime qeraje ambjneti	7,199,390	628,265
Shpenzime qeraje paisjeje	1,963,470	171,345
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni		-
Komisione dhe honorare	831,000	2,397,631
Shërbime nga të tretë	4,769,617	78,236
Publicitet, reklama		-
Dieta stafi		39,240
Karburant		-
Mirëmbajtje dhe riparime		1,231,758
Abonime		-
Personel jashte njesise		9,000
Shpenzime te tjera	65,096	-
Komisione bankare	45,663	46,608
Taksa të ndryshme	74,500	65,333
Gjoha të ndryshme	50,018	927
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	1,000,000	4,000
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	-	-
	15,998,754	4,672,343

17. SHPENZIME PERSONELI

Ne kete ze perfshin shpenzimet e personelit qe lidhen me pagat dhe sigurimet shoqerore e shendetesore pjesa qe I takon punedhenesit .

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime për paga	55,869,611	33,257,366
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndeti	7,420,609	5,029,293
	63,290,220	38,286,659

18. SHPENZIME AMORTIZIMI

Ne kete ze perfshin shpenzimet e amortizimit per paisjet e blera gjate 2023 te llogaritura me normat e percaktuara sipas legjislacionit tatimor qe lidhen me pagat dhe sigurimet shoqerore e shendetesore pjesa qe I takon punedhenesit .

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Shpenzime amortizimi	157,024	-
	<u>157,024</u>	<u>-</u>

19. SHPENZIME FINANCIARE

Ne kete ze perfshihen shpenzimet financiare nga llogaria Fitime /Humbje nga kembimi valutor .

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Shpenzime për interesa		(1)
Të ardhura nga interesat		-
Humbje nga këmbimet valutote	(291,696)	(307,587)
Të ardhura nga këmbimet valutore		-
Të ardhura nga rimarrje granti		-
Të tjera	61,076	-
	<u>(230,620)</u>	<u>(307,588)</u>

20. TATIMI MBI FITIMIN

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
<i>Fitimi para tatimit</i>	(7,271,245)	(9,900,784)
Total shpenzime të panjohura	1,050,018	4,927
Shpenzime udhëtimi		
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	50,018	927
Vlera kontabël e AAM të shitura		
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)		
Shpenzime të tjera	1,000,000	4,000
Rrimarrje zhvlerësimi (provizione) inventari		
Të ardhura nga gjyqi për njohjen e TVSH		
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e</i>	<i>(6,221,227)</i>	<i>(9,895,857)</i>
Humbje fiskale e mbartur		
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<u><u>(6,221,227)</u></u>	<u><u>(9,900,784)</u></u>

21. NGJARJE PAS DATEST SE RAPORTIMIT FINANCIAR .

Perveç sa me sipër, nuk ka ngjarje të tjera pas dates se raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

COBEUS Hoxha



TOP NEWS

Shoqëri e Kufizuar me Përgjegjësi me Kufizime

Albania